



DYRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY

24.04.2024

NJOFTIM FITUESI

Fondacioni "Dyrrah City Football Academy" (më tej referuar si "Fondacioni") njofton mbylljen e procedurës konkurruese për zgjedhjen e Klubit të Futbollit, anëtar i Federatës Shqiptare të Futbollit, në kategorinë "Abissnet Superiore", i cili do të financojë ndërtimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës. Klubi fitues është "Futboll Club Dinamo City" sh.a. (më tej referuar si Klubi "Dinamo City").

Fondacioni publikoi Ftesën për Propozim më datë 2 shkurt 2024, ku ftoi propozime të vulosura nga të gjitha klubet pjesëmarrëse në kategorinë "Abissnet Superiore". Në konkurim paraqiti propozim një Kandidat, Klubi "Dinamo City".

Në bazë të Ftesës për Propozim, kriteri përzgjedhës i propozimit fitues është propozimi që ofron afatin më të shkurtër të përfitimit të të ardhurave nga të ardhurat e marra nga transferimi dhe huazimi i lojtarëve të Akademisë së Fondacionit dhe kompensimit për trajnim dhe solidaritet, brenda afatit maksimal të përcaktuar si 120 (njëqind e njëzet) muaj, nga data e firmosjes së kontratës ndërmjet Fondacionit dhe Kandidatit të suksesshëm.

Propozimi i paraqitur nga Klubi "Dinamo City" u shqyrtua në tërësi, dhe rezultoi se Klubi "Dinamo City" plotëson kriteret dhe kushtet e kualifikimit, si dhe ka paraqitur një propozim të vlefshëm duke ofruar një afat prej 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) muaj. Si rezultat, "Futboll Club Dinamo City" sh.a. shpallet fitues për zbatimin e kontratës "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës" në përputhje të plotë me dokumentacionin e Ftesës për Propozim, dhe çdo shtojcë të saj.

Kontrata "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës" e lidhur ndërmjet Fondacionit "Dyrrah City Football Academy" dhe Dinamo City Football Club sh.a, parashikon se Klubi do të rimbursohet nga të ardhurat e përfituara nga transferimi dhe huazimi i lojtarëve



Rr. Petrit Kokalari, Nr. 57, Tiranë
Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës



+355 69 99 48 675



info@dcfa.al



www.dcfa.al

NIPT:

M3220202701W



DYRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY

të Akademisë së Fondacionit dhe kompensimet për trajnim dhe solidaritet, siç janë parashikuar në "Rregulloren për statutin dhe transferimin e Lojtarëve" të FSHF dhe FIFA, si dhe të drejtat e përdorimit të infrastrukturës dhe ambienteve të Kompleksit të Akademisë Durrës, pa pagesë, në përputhje me Marrëveshjen e Posaçme, në këmbim të financimit të projektit dhe ndërtimit të infrastrukturës me kapacitetet e Klubit.

Drejtori Ekzekutiv DCFA

Gjergj NDOCI

Fondacioni "Dyrrah City Football Academy"

Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës



Rr. Petrit Kokalari, Nr. 57, Tiranë
Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës



+355 69 99 48 675



info@dcfa.al



www.dcfa.al

NIPT:

M3220202701W